

**THIRRJE
TERMAT E REFERENCËS**

Organizata	Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara - Handikos Ferizaj
Lloji i konsulentë	Expert/e apo Kompani Softuerike
Lokacioni	Ferizaj, Kosovë
Data e Fillimit	05 Tetor 2022

Handikos Ferizaj

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit. Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

Handikos Ferizaj, që nga muaji shtator 2022 ka filluar implementimin e projektit **“Përfshirja sociale dhe parandalimi i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara”** që ka për qëllim përfshirjen e interesave të personave me aftësi të kufizuara në politikat lokale përmes hartimit të planit të veprimit për shërbimet sociale në Komunën e Ferizajt, i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Suedia), Qeveria e Dukatit të madh të Luksemburgut dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Qëllimi i përgjithshëm

Handikos Ferizaj, si organizatë që punon në mbrojtje të, të drejtave dhe interesave të personave me aftësi të kufizuara, synon edhe rritjen e angazhimit të grupeve të interesit në politikë-bërje, planifikim buxhetor në nivel lokal dhe përbushjen e përgjegjësisë ligjore të qeverisjes lokale lidhur me sigurimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara. Për këtë arsyeje, po kërkojmë një Ekspert/e apo Kompani i/e cili/a do të jetë përgjegjës/e për zhvillim të softuerit për përpilim të intervistave online që do të mbahen me ofruesit e shërbimeve, personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit/kujdestarët e tyre.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sigurimi i platformës për intervista online/programit softuerik;
- Mirëmbajtje;
- Trajnim në mbështetje për ekipin
- Realizimi i video animacionit në 2D

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare të fushës apo të ngjashme;
- Përvojë paraprake me tematikë të ngjashme;
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuara në kontekstin vendor;
- Shkathtësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;

- Shkathësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim;
- Përfshirë koston financiare sipas kërkesë për kuotim;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV);
- Certifikatë Biznesi (për kompanitë).

Kohëzgjatja dhe pritjet

- Eksperti/e apo Kompania, do të angazhohet për një periudhë një (1) vjeçare.
- Angazhimi do të bëhet me faza gjatë gjithë implementimit të projektit dhe do të jetë në dakordim të plotë mes palëve të përfshira

Pagesa

Pagesa për Ekspert/e apo Kompani do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësive të kontraktura, varësisht nga ditët (shërbimi) i pranuar.

Procedurat e aplikimit

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në e-mail adresën: handikosferizaj@gmail.com me subjektin *Aplikoj për "Ekspert/e apo Kompani Softuerike"*, Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **30.09.2022 ora 23:59h**.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.